



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

nr. 3501 prot.

Vlorë, më 26.12.2017

VENDIM

Nr 38 Datë 20 / 12 / 2017

Për miratimin e rishikimit të Programit të Transparencës së Këshillit të Qarkut Vlorë

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur në datën e sipërpërmendur, në zbatim të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 9 pika 1.1 gërma a dhe b, neni 77 gërma k dhe Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", nenet 4, 6, 7 dhe 8, Ligjit nr. 8517 datë 22.7.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, Ligjit nr.9131 datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike"

VENDOSI:

- 4) Te miratojë rishikimin e Programit të Transparencës së Këshillit të Qarkut Vlorë, bashkëlidhur këtij vendimi.
- 5) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut.
- 6) Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 78 pika 3.

KRYETARI

Ervis Moçka

Shpallur nga Prefekti I Qarkut Vlorë me shkresën me nr. 17 prot. Dt. 04 / 01 / 2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE
LIDHJA NR. 1
PROGRAMI I TRANSPARENCËS
PËR
KËSHILLIN E QARKUT VLORE

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Këshillin e Qarkut Vlorë. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”(LDI). Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Këshilli i Qarkut Vlorë ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. Këshilli i Qarkut Vlorë do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Këshillit të Qarkut Vlorë, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.qarkuvlore.gov.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Këshilli të Qarkut Vlorë është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj. Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së Këshilli të Qarkut Vlorë janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: Këshilli i Qarkut Vlorë ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e Këshilli të Qarkut Vlorë dhe përkatësisht: Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
4. Informacioni përshatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.

5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale” (këtej e tutje KDIMDP).

6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë: - i plotë; - i saktë; - i përditësuar; - i thjeshtë në konsultim; - i kuptueshëm; - lehtësisht i aksesueshëm; - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Këshilli i Qarkut Vlorë vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.qarkuvlore.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- ♣ Strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë;
- ♣ Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- ♣ Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- ♣ Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të Këshilli i Qarkut Vlorë, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- ♣ Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- ♣ Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi Këshillin e Qarkut Vlorë, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- ♣ Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur Këshilli i Qarkut Vlorë vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- ♣ Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të Këshilli i Qarkut Vlorë, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- ♣ Informacion për shërbimet që Këshilli i Qarkut Vlorë i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës

shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohej i dobishëm nga autoriteti publik;

♣ Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e Këshillit të Qarkut Vlorë, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të Këshillit të Qarkut Vlorë, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor Këshilli i Qarkut Vlorë për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

♣ Këshilli i Qarkut Vlorë, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;

♣ Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga Këshilli i Qarkut Vlorë.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Këshilli i Qarkut Vlorë vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [www.qarkuvlore.gov.al] dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

V. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENÇËS SË KËSHILLIT TË QARKUT VLORË

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	Vendimi për miratimin e strukturës organizative të Këshillit të Qarkut Vlorë dhe institucioneve vartëse Organigrama e funksionimit të administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë	Menjëherë pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut	Vendoset e plotë ose në link	Koordinatori; Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve
Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Ligji Nr139/2015, “Për veteqeverisjen vendore” Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” Ligji nr. 8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” Ligji nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” Ligji Nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”	Pas hyrjes në fuqi	Vendoset e plotë ose në link	Koordinatori;
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g	Dokument shpjegues për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, Formularin-tip për kërkesë për informacion adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Menjëherë pas miratimit të programit të transparencës së Këshillit të Qarkut Vlorë	Vendoset e plotë	Koordinatori;
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/ç	Dokument me informacion të detajuar për të dhëna për vendndodhjen e zyrave të Këshillit të Qarkut Vlorë, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit.	Menjëherë pas miratimit të programit të transparencës së Këshillit të Qarkut Vlorë	Vendoset e plotë	Koordinatori;

Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d	Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr139/2015, “Për veteqeverisjen vendore”	Menjëherë pas miratimit të programit të transparencës së Këshillit të Qarkut Vlorë	Vendoset e plotë ose me link	Koordinatori;
Mekanizmat monitorues; raporte audit; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	Mekanizmat monitorues; raporte audit; dokumentet me tregues performance	Menjëherë pas përfundimit zyrtar të kontrollit të autoritetit auditues	Vendoset e plotë ose me link	Koordinatori; Drejtoria Ekonomike dhe e Sherbimeve
Buxheti	Neni 7/1/e	VKQ “Për miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë”	Menjëherë pas shprehjes së ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut	Vendoset me link	Koordinatori; Drejtoria e Ekonomike dhe Sherbimeve
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat Ligji nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik” Ligji nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” Regjistri i parashikimit të prokurimeve publike; Regjistri i realizimit të prokurimeve publike;	Menjëherë pas miratimit të procedurave nga titullari i entit prokurues Këshillit të Qarkut Vlorë	Vendoset i plotë ose me link	Koordinatori; Njësia e Prokurimeve Publike
Shërbimet e autoritetit për publikun.	Neni 7/1/f	Informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit	Menjëherë	Vendoset i plotë ose me link	Koordinatori; Drejtoritë sipas shërbimeve që ofrojnë për publikun
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/gj	Dokument shpjegues për mënyrën e paraqitjes së mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Menjëherë	Vendoset i plotë ose me link	Koordinatori;
Mbajtja e dokumentacionit nga Këshilli I Qarkut Vlorë	Neni 7/1/h	Dokument shpjegues përmbledhës për mënyrën dhe llojin në dokumentacionit që administron Këshillit të Qarkut Vlorë mënyrën e shfrytëzimit të këtij dokumentacioni nga publiku.	Menjëherë	Vendoset i plotë ose me link	Koordinatori; Drejtoria e Ekonomike dhe Sherbimeve / Specialisti i arkiv-protokollit

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.	Neni 7/1/i	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014 (lidhja 2)	Menjëherë	Vendoset i plotë ose me link	Koordinatori
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Formularë të ndryshëm aplikimi	Menjëherë	Vendoset i plotë ose me link	Koordinatori
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l	Të gjitha vendimet e Këshillit të Qarkut Vlorë Njoftimet e punësimit me të dhëna sipas përcaktimeve të ligjit 152/2013 Informacione mbi aktivitetet e Këshillit të Qarkut Vlorë	Sipas afateve ligjore të miratimit dhe publikimit të tyre	Vendoset i plotë ose me link	Koordinatori Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve